



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Nr. 601 prot.

Tiranë, më 22.4.2024

**Vendim**

Nr. 43 datë 22 prill 2024

**Për disa avancime në titullin *akademik* dhe zgjedhjen e *anëtarëve të jashtëm* të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**

- Asambleja e Akademisë së Shkencave, e mbledhur më datë 22 prill 2024;
- Referuar neneve 6 e 8 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (i ndryshuar); e neneve 7 pika 10 dhe 10 të Statutit;
  - Në përputhje me vendimin nr. 21, datë 23.2.2024 të Asamblesë për fillim procedure për disa avancime në titullin *akademik*;
  - Në përputhje me rendin e ditës njoftuar Asamblesë sipas vendimit të Kryesisë nr. 38, datë 12.4.2024;
  - Pasi u njoh me raportin e komisionit teknik për procedurat e ndjekura e plotësimin e kriterëve prej kandidatëve zhvilloi procesin zgjedhor e në bazë të procesverbalit të komisionit të votimit (bashkëngjitur),

**Vendosi:**

**I. Fitojnë titullin *akademik* anëtarët e Asamblesë me titull të mëparshëm *akademik i asociuar*:**

1. Adrian Civici;
2. Kristina Jorgaqi-Jano;
3. Mimoza Hafizi;
4. Rajmonda Bualjoti.

**II. Pranojen anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:**

1. Angelin Preljocaj;
2. Ermira (Mira Murati);
3. Gëzim Alpion;
4. Lea Ypi;
5. Lulzim Tafa.

**III. Ceremonia e dorëzimit të diplomave për anëtarët që kanë fituar titullin akademik dhe për të zgjedhurit anëtarë të jashtëm të ASHSH të bëhet me solemnitetin e parashikuar në Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet në Akademinë e Shkencave.**

**IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave.**

**KRYETARI**

**Akad. Skënder GJINUSHI**

